



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 6939 prot.

Shkodër, më 01.04 2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni.

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin:

“Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit tip ndërmjet bashkisë Shkodër dhe distributorëve vendas dhe të huaj për shfaqjen e prodhimeve audiovizuale në Kinema “Republika”.

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETAR



Benet BECI

Shkresë percjellese: 2 flete

P/vendim: 2 flete

Relacion: 2 flete

Marrëveshje tip: 5 flete



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 6939 prot.

Shkodër, më 01 04. 2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, datë _____. _____. 2025

**“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT TIP NDËRMJET
BASHKISË SHKODËR DHE DISTRIBUTORËVE VENDAS DHE TË HUAJ PËR
SHFAQJEN E PRODHIMEVE AUDIOVIZUALE NË KINEMA “REPUBLIKA”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____/____/2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligji nr. 10352 datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar; Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për Kinematografinë” i ndryshuar; Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar; VKB nr 1, datë 22.01.2016 “Për taksat e tarifat vendore në Bashkinë Shkodër” i ndryshuar; VKB nr.76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 20/25 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar.

VENDOSI :

1. Të miratojë marrëveshjen e bashkëpunimit tip ndërmjet bashkisë Shkodër dhe distributorëve vendas dhe të huaj për shfaqjen e prodhimeve audiovizuale në Kinema "Republika".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR



Zv/Kryetar
Rudin Beka

Drejtoria e Kulturës

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës,
dhe e Sportit

PANDI LACO

Drejtoria e Përgjithshme Juridike,
Burimeve Njerëzore dhe Sherbimeve Mbështetëse

Denis Lesha

Drejtoria e përgjithshme e menaxhimit financiar

Teuta Haxhi

Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore

Halir Bilali



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KULTURËS DHE SPORTIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____, 2025

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT TIP NDËRMJET
BASHKISË SHKODËR DHE DISTRIBUTORËVE VENDAS DHE TË HUAJ PËR
SHFAQJEN E PRODHIMEVE AUDIOVIZUALE NË
KINEMA “REPUBLIKA”.**

Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Kinemaja është një strukturë që ka një ndikim të madh në zhvillimin dhe nxitjen e jetës kulturore artistike në qytetin e Shkodrës. Pas shumë viteve Kinema “Republika” po rikthehet në një institucion të denjë të kulturës. Ne tashmë jemi në proces të një rikonstruksioni të ambienteve të Kinemasë, për të krijuar mjedise dhe kushte bashkëkohore në këtë institucion të rëndësishëm të kulturës dhe artit në qytet.

Gjithashtu bashkia Shkodër është angazhuar që të rikthejë në Kinema funksionin parësor, atë të shfaqjes së filmave bashkëkohorë shqiptar dhe të huaj.

Në përputhje me ligjin nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për Kinematografinë” i ndryshuar dhe ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar; që të mundësohet shfaqja e filmave bashkëkohor duhet që bashkia të krijojë marrëdhënie bashkëpunimi me Distributorë të licencuar, të cilët kanë të drejtën ekskluzive të shfaqjes së këtyre filmave në të gjithë rajonin.

Bashkia Shkodër në paketën fiskale të miratuar me Vendim të këshillit bashkiak nr. 53 datë 29.12.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vkb nr 1, datë 22.01.2016 “Për taksat e tarifave vendore në Bashkinë Shkodër” ka miratuar vlerën e biletave të diferencuara.

Për shfaqjen e filmave bashkëkohorë të huaj në kinema është e detyrueshëm krijimi i marrëdhënieve kontraktuale me distributorë të prodhimeve audivizuale vendase dhe të huaja, të cilën e kemi paraqitur në këtë projekt vendim për miratim. Kjo marrëveshje do të ketë si efekt financiar gjysmën e vlerës të biletave të shitura për çdo film të shfaqur sipas marrëveshjes me distributorin.


Deri tani bashkia ka operuar përmes aplikimit të tarifave të qirasë për përdorimin e sallës për seancë screening (tarifa të përcaktuara në paketën fiskale), por kjo procedurë është e vlefshme vetëm për filma që prodhohen në Shqipëri që rezultojnë edhe gjithashtu më pak e favorshme sa i takon arkëtimit të të ardhurave në krahasim me arkëtimin e biletave për çdo film të shfaqur.

Duke vlerësuar impaktin pozitiv që ka kinemaja në jetën social kulturore të qytetit, si dhe duke synuar përmirësimin e cilësisë së e filmave të shfaqur në kinema përfshirë këtu edhe filmat e huaj bashkëkohorë propozojmë miratimin e Marrëveshjes Tip me distributorët vendas dhe të huaj për shfaqjen e prodhimeve audiovizuale në kinema “Republika”.


Sa më sipër, në përputhje me ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligji Nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, te ndryshuar; Ligji nr. 10352 datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar; Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për Kinematografinë”i ndryshuar; Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar; Vendim të këshillit bashkiak nr. 53 datë 29.12.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vkb nr 1, datë 22.01.2016 “Për taksat e tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”, propozojmë për miratim para Këshillit Bashkiak projekt vendimin “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit tip ndërmjet bashkisë Shkodër dhe distributorëve vendas dhe të huaj për shfaqjen e prodhimeve audiovizuale në Kinema “Republika”.

Duke Ju falenderuar !

Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit

PANDI LEO


Drejtoria e Kulturës

Sana Samaj




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA SHKODËR

DISTRIBUTORI

Nr. _____ Prot.

Shkodër, më ____ / ____ /2025

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur ndërmjet palëve:

BASHKISË SHKODËR përfaqësuar nga Z. Benet Beci, në cilësinë e titullarit të Institucionit, me adresë Rr. "13 Dhjetori", Nr 1, Shkodër, Shqipëri me NIPT K36813001H, këtë e tutje i cilësuar si "Bashkia".

dhe

_____ subjekt fizik/juridik me adresë: _____ me numër regjistrimi _____ dhe NIPT _____, këtu referuar si "DISTRIBUTOR", përfaqësuar nga _____.

Palët bien dakort për sa më poshtë:

NENI 1

Objekti

1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është përcaktimi i detyrimeve, të drejtave dhe përgjegjësisive respektive të palëve në kuadër të bashkëpunimit për shfaqjen e filmave në Kinema "Republika".

NENI 2

Qëllimi

2.1 Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi ndërmjet bashkisë Shkodër dhe distributorit për shfaqjen e prodhimeve audiovizuale të filmave bashkëkohorë shqiptar dhe të huaj në Kinemane "Republika" duke e rikthyer Kinemanë në funksion dhe me efektivitet në shërbim të qytetarëve.

NENI 3

Baza Ligjore

Ligji Nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;

Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar

Ligji nr. 10352 datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar;

Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 "Për Kinematografinë" i ndryshuar;

Ligji nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", i ndryshuar;

NENI 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

4.1 Distributori është person fizik/juridik apo një grup fizikë a juridik vendas apo të huaj, mbajtësi ekskluziv i të drejtave ekskluzive të prodhimeve audiovizuale që do të jenë objekt i marrëveshjes për territorin e Shqipërisë dhe është i autorizuar t'i shpërndajë ato në përputhje me kuadrin ligjor, në vijim të referuara si "Film".

4.2 Distributori i jep bashkisë të drejtën për të ekspozuar me projeksion të drejtpërdrejtë Filmat në Kinema "Republika" të referuar në vijim si "Kinema". Filmat janë të plotë, me ngjyra dhe në versionin origjinal të gjuhës (anglisht) të dubluar ose të subtitruar në gjuhën shqipe.

4.3 Distributori do t'i dorëzojë bashkisë një kopje të secilit Film në formatin dixhital DCP (2D/3D), së bashku me materialet bazë promovionale.

4.4 Distributori do të marrë përsipër kostot e dorëzimit për të gjithë Filmat dhe materialet e tyre promocionale bazë.

4.5 Bashkia angazhohet të raportojë çdo ditë jo më vonë se ora 10:00 të gjitha shitjet e biletave dhe të ardhurat e mbledhura një ditë më parë. Gjithashtu, bashkia do të përgatisë dhe do të dorëzojë një raport javor mbi shitjet për periudhën e enjte deri të mërkurën duke përfshirë deri në orën 12:00.

4.6 Raportimi ditë dhe javor duhet të përfshijë elementët e mëposhtëm të rëndësishëm: titullin e filmit, numrin e shfaqjeve për sallën e kinemasë, orët (kohën) e shfaqjeve për filmin, çmimin e biletës për çdo lloj bilete së bashku me specifikimet nëse janë VIP, normale, grupe ose në ofertë (me zbritje), si dhe shumën Neto dhe Bruto të shitjeve ditore dhe javore.

4.7 Bashkia, jo më vonë se tre ditë pas përfundimit të periudhës së lëshimit, do të kthejë kopjen e materialeve DCP dhe materialeve promocionale në adresën e të Distributorit në gjendje të mirë siç është marrë në dorëzim.

NENI 5

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

5.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët përkatëse.

5.2 Të drejtat e dhëna janë për një periudhë 12 mujore, në vijim referuar si “kohëzgjatje”, e cila fillon në ditën e parë të shfaqjes në kinema për secilin nga Filmat.

5.3 Kohëzgjatja mund të ndryshojë vetëm përmes komunikimit me shkrim ndërmjet palëve. Bashkia duhet të njoftojë Distributorin për ditën e parë të ekspozimit të Filmit në kinema.

5.4 Marrëveshja shoqërohet me anekset përkatëse ku renditen të gjithë filmat për të cilët ka të drejta, me datat e planifikuara të fillimit të tyre. Datat mund të ndryshohen pasi të merret konfirmimi për çdo ndryshim edhe nga Bashkia Shkodër. Ekspozuesi do të njoftojë Bashkinë se cilët tituj do të përfshijë në programin e tij dhe në cilat data sipas marrëveshjeve respektive.

NENI 6

Komunikimi ndërmjet Palëve

6.1 Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Si rregull, komunikimi kryhet në formë shkresore, por edhe format e komunikimit elektronik zyrtar.

6.2 Per efekt vlefshmërie të kësaj marrëveshje pranohet edhe komunikimi elektronik zyrtar sa i takon nënshkrimit të saj dhe/ose nënshkrimi elektronik.

6.3 Në zbatim të kësaj marrëveshje, palët caktojnë nga një person kontakti që është përgjegjës për komunikimin ndërmjet palëve.

6.4 Personat e kontaktit janë si më poshtë vijon:

Bashkia Shkodër cakton si përfaqësues Z/Z.nj _____ me adresë e-mail: _____ ose nr. cel: +355 _____.

Distributori emëron përfaqësues të tij Z/Znj. _____, me adresë e-mail: _____ ose nr.cel: +355 _____.

NENI 7

Kufizimet

7.1 Të gjitha të drejtat që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë marrëveshje në lidhje me shfaqjen e prodhimeve audiovizuale të filmave bashkëkohorë shqiptar dhe të huaj në Kinemane "Republika" janë të rezervuara nga Distributori. Bashkia nuk ka të drejtë të shfrytëzojë Filmat në asnjë formë tjetër përveç të drejtave të dhëna në mënyrë specifike këtu, projektion të drejtpërdrejtë në ekranet e kinemasë.

NENI 8

Detyrimet financiare

8.1 Si kompensim për të drejtat e dhëna përmes kësaj marrëveshje, Bashkia do t'i paguajë Distributorit një shumë të barabartë me gjysmën e vlerës neto të të gjitha të ardhurave të krijuara nga shitja e biletave.

8.2 Proçedura e realizimit të pagesave do të përcaktohet në momentin që arrihet dakordësia me distributorin.

NENI 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.
2. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhet përmes bisedimeve dhe mirëkuptimit, palët do t'i drejtohen Gjykatës kompetente Shqiptare.

NENI 10

Dispozita të fundit

NENI 10

Dispozita të fundit

10.1 Interpretimi i kësaj marrëveshjeje, termat dhe kushtet e saj do të bazohen në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

10.2 Kjo marrëveshje mund të anulohet vetëm me dakordesi me shkrim të ndërsjellë nga palët.

10.3 Çdo ndryshim ose modifikim i kësaj marrëveshjeje duhet të plotësohet me shkrim dhe të nënshkruhet nga palët.

10.4 Nëse ndonjëra nga palët nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje, atëherë secila prej tyre ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim dhe fitim të humbur.

10.5 Secila palë ka të drejtë të zgjidhë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme, duke e njoftuar palen tjetër në një afat 15 ditore në lidhje me arsyet e ndërprerjes, nëse detyrimet e ndërsjella sipas kësaj marrëveshjeje nuk përmbushen dhe respektohen.

10.6 Marrëveshja është hartuar në gjuhën shqip dhe angleze, në rastin e distributorëve të huaj, në katër kopje, dhe palët e kanë nënshkruar pas leximit dhe mirëkuptimit, duke marrë nga dy kopje secila.

DISTRIBUTORI

PERFAQESUES LIGJOR

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Benet BECI